



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
KOORDINATORI KOMBËTAR
KUNDËR KORRUPSIONIT

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Nr. 3258 prot., datë 06.06.2022

Nr. 2158 prot., datë 06.06.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

KOORDINATORIT KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

DHE

INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

“PËR BASHKËPUNIMIN E NDËRSJELLTË NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT”

Tiranë, 2022

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, (këtu e në vazhdim referuar si “Marrëveshja”) lidhet midis:

1. **Ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit,** (referuar më poshtë si “KKK”), përfaqësuar nga Z. Ulsi Manja, Ministër.

dhe

2. **Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,** (referuar më poshtë si “ILDKPKI”), përfaqësuar nga Znj. Evgjeni Bashari, Inspektor i Përgjithshëm.

Hyrje

- *Duke vlerësuar* rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për forcimin e shtetit të së drejtës, me qëllim luftën kundër korrupsionit dhe ndëshkimin e paligjshmërive, me synim garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe rritjes së integritetit të nëpunësve të organeve publike, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të lirë demokratik.
- *Duke synuar* angazhimin e përbashkët lidhur me nxitjen e qytetarëve për denoncimin e rasteve korruptive, praktikave arbitrare ose abuzive, në institucionet pjesë të rrjetit kundër korrupsionit, si dhe promovimin e praktikave më të mira në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet përmbushjes së detyrimit për zbatimin e normave përkatëse sipas parashikimeve ligjore.
- *Duke konfirmuar* angazhimin institucional të palëve nënshkruese për të marrë të gjitha masat dhe nismat e nevojshme për rritjen e informimit, ndërgjegjësimit në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe rritjes së integritetit të nëpunësve/punonjësve të organeve publike.
- *Duke u mbështetur* në kuadrin ligjor në fuqi, si dhe në parimin e përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje, duke respektuar dispozitat e saj, të shprehura si më poshtë:

Neni 1 **Qëllimi**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjellët në kuadër të luftës kundër korrupsionit, me qëllim shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve të kësaj marrëveshjeje, në lidhje me subjektet që mbartin detyrimin për deklarim në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Neni 2 **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në vendimin nr. 606, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, si dhe në vendimin nr. 618, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, i ndryshuar.

Neni 3 **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi midis palëve lidhur me:

1. Realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave me qëllim rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për forcimin e luftës kundër korrupsionit.
2. Koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të hetimit administrativ të subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim të interesave privatë, për të cilët Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit në kuadër të një hetimi administrativ:
 - ka bërë kallëzim penal apo;
 - ka rekomanduar dhënien e masave disiplinore dhe për të cilët ka dyshim të arsyeshëm se mund të jenë të përfshirë në veprime korruptive.
3. Bashkëpunimin e palëve për identifikimin dhe zbatimin e formave të qëndrueshme dhe efektive të bashkëpunimit, në përputhje me kompetencat përkatëse institucionale, me qëllim promovimin e nismave për çështje që lidhen me luftën kundër korrupsionit dhe zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Angazhimet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

1. ILDKPKI-ja merr përsipër që në përfundim të kontrolleve të deklaratave të interesave private të subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim, të ushtruar në zbatim të përcaktimeve ligjore dhe në rast zbulimi të praktikave abuzive, korruptive apo arbitrare, të cilat janë objekt i veprimtarisë së Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit, ti dërgojë Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, një kopje të dokumentave të nevojshëm në një kohë sa më të shpejtë.
2. ILDKPKI-ja merr përsipër që në përfundim të kontrolleve të iniciuara mbi bazën e informacionit të marrë nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, të informojë këtë të fundit për rezultatet e këtyre kontrolleve.

Neni 5

Angazhimet e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit

1. Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit merr përsipër të njoftojë në një kohë sa më të shpejtë ILDKPKI për rastet kur gjatë kontrolleve/hetimeve, konstaton raste korruptive, praktika abuzive ose arbitrare nga ana e zyrtarëve, të cilët janë subjekt i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe për rezultatet e arritura në vijim të informacioneve të marra nga ILDKPKI.
2. Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit merr përsipër të njoftojë në çdo rast ILDKPKI për rastet e hetimeve të zhvilluara, ku në përfundim të hetimit konstatohet (dyshohet) se procedurat administrative apo aktet e vendimmarrjes të organit publik, janë nxjerrë në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe për rezultatet e arritura në vijim të informacioneve të marra nga ILDKPKI.

Neni 6

Kontribute të përbashkëta

Palët angazhohen të informojnë reciprokisht njëri-tjetrin sipas angazhimeve të ndërmarra në këtë marrëveshje, si dhe marrin përsipër të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, për ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe nëpunësve/punonjësve të organeve publike në luftën kundër korrupsionit, me qëllim forcimin e zbatueshmërisë së ligjit, shmangien e rasteve të konfliktit të interesit, rritjen e integritetit të administratës publike dhe garantimin e të drejtave të çdo qytetari në këtë drejtim.

Neni 7
Administrimi i informacionit

1. Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të dhëna nga pala tjetër dhe kanë detyrimin e mos shpërndarjes së këtij informacioni tek personat e paautorizuar.
2. Informacioni i shkëmbyer në kuadër të kësaj marrëveshje ndërmjet palëve nënshkruese do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8
Komunikimi ndërmjet palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe/ose në rrugë elektronike.
2. Palët caktojnë një person kontakti, nëpërmjet të cilit do të kryhet shkëmbimi i informacionit në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi. Palët, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes, caktojnë një person kontakti dhe ia njoftojnë atë njëra-tjetrës.
3. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi palët respektive lidhur me problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje.

Neni 9
Ndryshimi dhe përfundimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet pjesërisht ose tërësisht me vullnetin e dakordësuar të palëve, i cili bëhet nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.
2. Gjithashtu, palët kanë të drejtë që me marrëveshje me shkrim midis tyre, të zgjidhin marrëveshjen në çdo kohë.
3. Në rast se njëra nga palët kërkon të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen, ajo duhet të njoftojë me shkrim brenda 1 (një) muaji palën tjetër.
4. Deri në përfundimin e kësaj marrëveshje, palët do të përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin prej saj, përsa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë kohe të pacaktuar.

Neni 12
Dispozita të fundit

1. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën fuqi juridike, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Ministrinë e Drejtësisë dhe 2 (dy) të tjera në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
2. Kjo marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 06.06.2022.

**KOORDINATORI KOMBËTAR
KUNDËR KORRUPSIONIT**

ULSI MANJA
(Ministër i Drejtësisë)



**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

EVGJENI BASHARI
(Inspektor i Përgjithshëm)

